



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E INTEGRITETIT, MBIQYRJES DHE ANKESAVE
ADMINISTRATIVE E GJYQËSORE
SEKTORI I ANKESAVE ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

Lënda: Mbi trajtimin e kërkesës për informim.

Z. H. M.

**Për dijeni: MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Tiranë**

Në vijim të kërkesës tuaj të datës 05.11.2024, protokolluar me tonën nr. 6024 prot, datë 06.11.2024, nëpërmjet së cilës, kërkonti rikthimin në detyrë në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ose në të kundërt, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, kërkonti të informoheni lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim padinë e ngritur nga ana juaj, me vendimin nr. 958, datë 01.03.2014, ka vendosur:

“- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë së paditësit H. M. kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë.

- Konstatimi i pavlefshmerisë absolute të aktit administrativ nr.5594/5 prot dt.11.12.2013 për kalimin e paditësit në listë pritje.

- Detyrimin e të paditurit Ministria e Shëndetësisë për të rikthyer paditësin H. M. në punë në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Shëndetësisë.

-Rrëzimin e padisë per pjesën tjetër të saj.”

Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 3762 datë 14.10.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 958 datë 1.03.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të sipërcituar.

Për sa më sipër rezulton se Gjykata ka urdhëruar rikthimin tuaj në detyrë, në pozicionin e *Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë*. Në lidhje me shpalljen e publikuar në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike (DAP), me nr. 6657, për pozicionin e “*Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*”, ju bëjmë me dije se nuk përputhet me pozicionin e përcaktuar në dispozitivin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili tashmë ka marrë formë të prerë.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATES PUBLIKE

Megjithatë ju sqarojmë se, në çdo rast është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) institucioni debitor që ka detyrimin ligjor për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favorin tuaj, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në Kreun IV, të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, *“Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”*.

E drejta për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore, është një e drejtë e konsoliduar tashmë edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila në paragrafin nr. 35, të vendimit nr. 47/2014, shprehet se: *“I takon palës debitore të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së palës kreditore. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë.”*

Në këto kushte, në përputhje me parashikimet e Urdhrit nr. 5151/2015, të sipërcituar, MSHMS-ja duhet të shqyrtojë mundësinë për sistemimin tuaj në pozicionet që janë aktualisht vakante dhe të përcjellë pranë DAP, akt-rekomandimin me propozimet konkrete, në përputhje me kriteret që gëzoni, me qëllim që njësia përgjegjëse të procedojë me nxjerrjen e aktit të rikthimit në detyrë.

Në përfundim, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor **38**, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,